



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 447/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Nenad Lazic dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Prishtinë paraqitur kundër menaxherit të votimit Nevzat Maliqi, në fshatin Busvatë, për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në Prishtinë.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 03.11.2013, nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në Prishtinë, në të cilën thekson se me datën 03.11.2013 në ora 14:44 në Qendrën e votimit 1023D në fshatin Busvatë menaxheri i vendvotimit Nevzat Maliqi i ka detyruar dy persona të votojnë me kusht, njëri prej tyre është Shehide Maliqi edhe pse personat në fjalë kanë qenë në listë të rregullt të votuesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se në Qendrën e votimit 1023D në fshatin Busvatë menaxheri i vendvotimit Nevzat Maliqi i ka detyruar dy persona të votojnë me kusht, njëri prej tyre është Shehide Maliqi edhe pse personat në fjalë kanë qenë në listë të rregullt të votuesve.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 447/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*